

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MEMO –CONSULTANT SUPERVISION DESIGN” SH.P.K.
DATË 17.09.2020

Sot, në datën 17.09.2020, Z. Arben MEMO, atësia Beqo, shtetas shqiptar, lindur më 08.07.1978, në Lushnjë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr 035195389 dhe nr. personal H80708177D, në cilësinë e Ortakut të vetëm Themelues, vendosi të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar **“Memo-Consultant Supervision Desing” Shpk (“MCSD”)**. Kjo shoqëri do të realizojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin, i cili i bashkëlidhet këtij Akt – Themelimi, si Shtojca A.

NENI 1– EMERTIMI

1.1 Shoqëria emërtohet **“Memo-Consultant Supervision Desing” Shpk** (në vijim **“Shoqëria/ MCSD”**).

NENI 2 – FORMA

- 2.1 Shoqëria **“Memo-Consultant Supervision Desing” Shpk** themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.
- 2.2 Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 3 – SELIA

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën **Njesia Bashkiake Nr.5,Rruga “Vaso Pasha”, Pall.32, Ap. 26., Tiranë, Shqipëri.**
- 3.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci në adresa të tjera si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- 3.3 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/ose mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe/ose njësi vendore të çdo lloji, ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë dhe/ose transferojë dhe/ose mbyllë adresa sekondare të ushtrimit të veprimtarisë, filiale dhe/ose agjenci.

NENI 4 – OBJEKTI

- 4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë konsiston në kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara më poshtë:
- a) Projektim të punimeve të ndërtimit, rikonstruksione, mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi dhe montimi në godina civile, industriale, bujqësore, turistike, shoqërore, veprave hidroteknike, sisteme të furnizimit me ujë, kanalizime të ndryshme, rrugë, ura dhe vepra arti, punime komunale dhe të mjedisit, si dhe punime të të gjitha llojeve në fushën e ndërtimit dhe montimit.

- b) Projektimi,ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve inxhinierike të ujërave dhe impianteve të ujërave të objekteve sportive,interiere, peisazhi,sipërfaqe të gjelbra,lulishte e parqe.
- c) Konsulencë inxhinierike në të gjitha fushat e inxhinierisë strukturale, hidroteknike, etj.
- d) Eksport-import dhe tregtim me shumicëe pakicë të të gjitha llojeve të materialeve dhe pajisjeve të ndërtimit,hidrosanitare,elektrike, të mallrave të ndryshëm industriale dhe mallra të të gjitha llojeve.
- e) Veprimtari e lidhur me asistencën teknike dhe asistencën inxhinierike të të gjitha shërbimeve të përmendura me sipër, etj.
- f) Vlerësimin e pasurive të paluajtshme për ndërtesa dhe tokë truall. Hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis,për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për problemet mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport vlerësimi të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.
- g) Studimi dhe përgatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri, të ndërtesave tëçdo lloji, si dhe hartimin e akteve të ekspertizës teknike për zjarret e rëna.
- h) Projektme, Masterplane-Studime, e plane rajonale urbanistike, plane rregulluese të përgjithshme, për qendra të banuara dhe qytete si dhe studime pjesore Urbanistike.
- i) Projektim-zbatim konstruktiv.
- j) Projektim-zbatim të objekteve të ndryshme, me konstruksione metalike. Projektim dhe rilevim gjeodezik për bazamente,projektme topografike, hartografike dhe fotogrametrike. Studime gjeologo - inxhinieriketë truallit, për të gjitha llojet e objekteve. Studime tësizmilogjisë inxhinierike.
- k) Projektme të sinjalizimit rrugor.
- l) Projektimi i impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë.
- m) Projektim i veprave hidroteknike dhe të ngjashme.
- n) Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie apo transaksioni tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të çfarëdo lloji dhe natyre, përfshirë edhe huamarrje/ huadhënie, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

ENI 5 – KOHËZGJATJA

5.1 Shoqëria themelohet me një kohëzgjatje të pakufizuar.

5.2 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

ENI 6 – KAPITALI I SHOQËRISË, KONTRIBUTET DHE KUOTAT

- 6.1. Kapitali i Shoqërisë është 100 ALL (njëqind lekë), i ndarë në 1 kuotë të zotëruar nga ortaku i vetëm themelues në masën 100% e kontributit në kapital.
- 6.2. Kuotat e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë janë lirisht të transferueshme sipas legjislacionit tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 6.3. Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe zotërohet nga Ortaku Themelues, në masën 100%.
- 6.4. Ortaku/ secili nga Ortakët e Shoqërisë përgjigjet për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të saj.


NENI 7 –TRANSFERIMI I KUOTAVE

- 7.1. Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 8 – ADMINISTRATORI/ËT

- 8.1. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratori/ët do të qëndrojnë/në në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pese) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 8.2. Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha të drejtat dhe kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe çdo rast në zbatim të kufijve të përcaktuar në aktin e emërimit të tij dhe/ose në Statutin e Shoqërisë.
- 8.3. Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë të posaçme (“*ad negotia*”) për kryerjen e një veprimi ose disa veprimeve, në kufijtë e tagrave që i/u janë dhënë nga ligji, statuti dhe/ose akti i emërimit.
- 8.4. Caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:
 “Z. Arben MEMO, shtetas shqiptar, lindur më 08.07.1978, në Lushnjë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në Tiranë dhe banuese në adresën: Rruga: “Vaso Pasha”, pall. 32, ap 26, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 035195389 dhe nr. Personal H80708177D, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar”

Specimeni i Firmës së Administratorit të Parë të Shoqërisë është si më poshtë:

Emër Mbiemër Arben Memo	Nënshkrimi 
-----------------------------------	--

NENI 9 – GJUHA

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

NENI 10 – DISPOZITA TË FUNDIT

10.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt - Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

* * *

Për:

“Memo–Consultant Supervision Design” sh.p.k.

ORTAK THEMELUES:

Arben Memo

Z.Arben MEMO

